


# Manuali i përdorimit

# eLeja

*Platforma elektronike eLeja mundëson lehtësimin e procedurave të aplikimit dhe trajtimit të kërkesave të prashtruara nga kërkuesit dhe shqyrtuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës.*

*Të gjitha të dhënat e shënuara nga kërkuesi, duhet të jetë të sakta.*

*E-maili i shënuar nga regjistruesi do të jetë e-maili kontaktues ku sistemi të gjitha shkresat zyrtare do t'i dërgoj në atë e-mail.*

*Hapat që duhet ndjekur për të dorëzuar një kërkesë në sistemin eLeja janë:*

*1. Regjistrohu;*
*2. Kliko në "Aplikim i ri" dhe plotëso të dhënat për të aplikuar;*
*3. Kontrollo e-mailin dhe sistemin eLeja për të vëzhguar kërkesën e Juaj.*
*4. Vendos njoftimin publik në parcelë në momentin e pranimit të e-mailit;*
*5. Plotëso kërkesën brenda afatit të kërkuar nëse kërkohet plotësim;*
*6. Shkarko Vendimin përfundimtar nga sistemi.*

## REGJISTRIMI NË eLeja




Kliko për tu regjistruar

Pas regjistrimit në sistemin online, i njëjti përdorues mund të bëjë kërkesë edhe për parcela kadastrale të tjera të cilat janë në pronësi të tij apo për të aplikuar posedon autorizimin e vërtetuar nga organi kompetent të dhënë nga pronari i parcelës kadastrale.




## Plotëso të dhënat personale të regjistruesit

- Të gjitha të dhënat e shënuara duhet të jenë të sakta.
- Adresa e shënuar duhet të jetë sipas sistemit të adresa për të krijuar mundësinë e dërgimit të vendimeve/shkresave zyrtare nga Drejtoria e Urbanizimit tek pronari përmes postës.

## Pas plotësimit të të dhënave, kliko REGJISTROHU

- Pas plotësimit të të dhënave dhe pas klikimit **Regjistrohu**, tani është krijuar mundësia e aplikimit online.

## QASJA NË eLeja




Shëno **adresën elektronike** dhe **fjalëkalimin** me anë të cilës jeni regjistruar dhe kliko në butonin **HYR**

# APLIKIM I RI




Për të procesuar një kërkesë të re, kliko në butonin **"Aplikim i ri"** i cili gjendet në këndim e majt të faqes apo kliko në butonin "kliko këtu" i cili gjendet në mes të faqes (shih foto nr. 5).




*Kliko në "zgjedh kategorinë"*




*- Pas klikimit në "zgjedh kategorinë" do ju shfaqen fazat e kategorisë së kërkesës andaj, zgjedhni kategorinë për kërkesën e juaj dhe kliko **vazhdo***




## **HAPI 1 -** Të dhënat e dorëzuesit

- Të dhënat e dorëzuesit janë të dhënat e aplikuesit.
- Tek pjesa Komuna, zgjedh vendbanimin
- Tek pjesa ***Adresa*** përshkruaj adresën e saktë të vendbanimit p.sh. Ulpiane, E32, Hyrja 1, Nr. 1, Prishtinë.
- Pas plotësimin të të dhënave, kliko ***Vazhdo*** për të vazhduar tutje në hapin 2.

*Vërejtje: nëse nuk keni plotësuar sakt njërën nga kolonat, butoni vazhdo nuk do të aktivizohet.*




## **HAPI 2 -** Të dhënat e ndërtuesit

- Në rast se kërkuesi do të jetë vet ndërtuesi (investitori), atëherë kliko në pjesën ***"jam vet ndërtuesi"***.

Vërejtje: nëse nuk keni plotësuar sakt njërën nga kolonat, butoni vazhdo nuk do të aktivizohet.




# **HAPI 3 -** Të dhënat e parcelës/ave kadastrale



01 - **Parcela Kadastrale nr.** - shëno vetëm numrin e parcelës p.sh. në fletën posesues që posedoni, numri i parcelës kadastrale është P-71914059-00325-2, ndërsa numri që duhet të shënohet është vetëm 325-2;

02 - **Zona Kadastrale** - zgjedh zonën kadastrale të cilën e gjeni në certifikatë të njësisë kadastrale të parcelës për të cilën parashtroni kërkesën;

03 - **Sipërfaqja $m^2$** - shëno siperfaqen e sakt të cilën e gjeni në certifikatë të njësisë kadastrale të parcelës për të cilën parashtroni kërkesën, p.sh. 350;

05 - Në rast se kërkesa juaj ka të bëjë me më shumë se një pronar (bashkëpronësi), tëherë kliko **"shto pronar tjetër"** dhe plotëso të dhënat e bashkëpronarit;

06 - **emri, mbiemri dhe nr. personal -** shëno të dhënat e emrit, mbiemrit dhe numrit personal të pronarit të cilat i gjeni në certifikatë të njësisë kadastrale;

07 - Në rast se në certifikatë të njësisë kadastrale, parcela juaj figuron të jetë në hipotekë, atëherë kliko ***"a është parcela në hipotekë"*** dhe ngarko fletën e skanuar ku dëshmohet hipoteka.
- Në rast se në parcelën kadastrale ku kërkohet ndërtimi, aklualisht në parcelë gjendet ndonjë ndërtesë ekzistuese, kliko ***"a ekziston ndërtesë në parcelë"*** dhe ngarko fotografi të gjendjes ekzistuese të ndërtesës si dhe në anën e dajthtë përshkruaj ndërtesën ekzistuese si: *Etazhiteti B+P+1+Nk, materialet nga betoni i armuar, ndërtuar në vitin 1984, posedon leje ndërtimi apo nuk posedon leje ndërtimi etj.*

08. - **shto parcelë -** Në rast kërkesa juaj ka të bëjë me më shumë se një parcelë kadaastrale, kliko në butonin *"shto parcelë"* dhe plotëso të dhnëat e parcelës së tjetër.

09. **- Vazhdo -** Pas plotësimit të të dhënave, kliko *Vazhdo.*

Vërejtje: nëse nuk keni plotësuar sakt njërën nga kolonat, butoni vazhdo nuk do të aktivizohet.




## **HAPI 4 -** Incizimi gjeodezik

Plotëso të dhënat e incizimit gjeodezik të gjendjes faktike të parcelës të punuar nga gjeodeti apo kompani gjeodezike e licencuar.
Në rast se incizimi gjeodezik është punuar nga përson fizik (jo kompani), pjesët e butonave ku në kllapa figuron teksti *"opsionale"* mos plotëso.




## HAPI 3 - Projekti koceptual

**01 - shto parcelë tjetër -** Në rast se projekti konceptual është punuar nga më shumë se një kompani projektuese kliko butonin +*shto projektues tjetër*;
**02 - Plani Hapësinor -** kliko në planin hapësinor dhe zgjedh planin hapësinor ku kërkohet ndërtimi i ndërtesës;
**03 - Kompania projektuese -** shëno emrin e sakt të kompanisë projektuese të cilin emër e gjeni në certifikatë të biznesit të kompanisë projektuese
**04 - Numri i biznesit -** shëno numrin e certifikatës së biznesit të kompanisë projektuese të cilin numër e gjeni në certifikatën ebiznesit të kompanisë projektuese;
**05 - Lloji i ndërtimit -** kliko në këtë buton dhe zgjedh llojin e ndërtimit që kërkohet për të caktuar kushtet ndërtimore;
**06 - Etazhiteti -** shëno etazhitetin e ndërtesës së planifikuar për të cilën parashtrohet kërkesa për kushte ndërtimore psh. B+P, B+P+1, P+0 etj.
**07 - Kërkesa për kushte ndërtimore (shtojca 1 e Udhëzimit Administrativ 06/2017 të MMMPH-së -** fillimisht shkarko shtojcën 1 të UA 06/2017 nga webfaqja e MMPH-s], plotëso, dhe e njëjta duhet të nënshkruhet nga kërkuesi. Pas plotëimit dhe nënshkrimit, e njëjta të skanohet dhe të ngarkohet në formatin JPEG ose PDF.
Pas plotësimit të të dhënave, kliko Vazhdo.

Vërejtje: nëse nuk keni plotësuar sakt njërën nga kolonat, butoni vazhdo nuk do të aktivizohet.




## Pranimi i aplikimit

Në rast se keni plotësuar tëgjitha të dhënat e kërkuara, dhe ju figoron **"aplikimi përfundoi"**, kërkesa juaj është dorëzuar në Drejtorinë e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës.




Nëse klikoni në pjesën paneli (butoni në anën e majt dhe të epërme të faqes), do të shihni lëndën e procesuar nga ana juaj.
Nëse në lëndën e procesuar figuron teksi ***"Pending"***, nënkupton që kërkesa juaj ende nuk është procesuar tek zyrtari përgjegjës për trajtimin e kërkesës.




Pas klikimit në kërkesën e procesuar nga ana juaj, Ju mund të shihni në cdo kohë të gjitha të dhënat e shënuara dhe ngarkuara nga ana Juaj dhe në çdo kohë mund të shkarkoni secilin dokument të veçantë apo të klikoni në butonin në pjesën e majt dhe të poshtëm të faqes **"shkrako dosjen"** ku mund të shkarkoni tërë dosjen e ngarkuar nga ana juaj.

Në momentin që Juve keni procesuar kërkesën, të dhënat e shënuara dhe ngarkuara nuk mund të ndryshohen nga ana juaj.




Nëse në kërkesën e procesuar figuron teksti **"In process"** dhe ndryshohet ngjyra kartës në të kaltërt, nënkupton që kërkesa është procesuar tek zyrtari përgjegjës dhe ka filluar procedura e trajtimit të kërkesës suaj.




- Nëse në kërkesën e procesuar figuron teksti i shtuar **"për plotësim"** , nënkupton që kërkesa është shqyrtuar nga zyrtarti përgjegjës i Drejtorisë së Urbanizmit të Komunës së Prishtinës dhe i njëjti **ka kërkuar plotësimin e dokumentacioni nga ana juaj**.
- Bashkangjitur me këtë Juve në mënyrë atuomatike keni pranuar edhe e-mail zyrtar nga Drejtoria e Urbanizmit ku e-mailit zyrtar i është bashkangjitur edhe kërkesa për plotësimin e dokumentacionit.
- Në pjesën e poshtme të kartës, ju do të shihni çdo kohë afatin e mbetur për plotësimin e dokumentacionit konform Udhëzimin Administrativ 06/2017 të MMPH-së.







Për plotësimin e kërkesës, ju fillimisht duhet të klikoni në kartën e lëndës. Pas klikimit, në pjesën e djathtë dhe të epërme të faqes, Juve do shihni kolonën e shtuar **"Plotësim dokumentacioni"** dhe kliko mbi të.

Pas klikimit, Juve do shihni tabelën e re ku keni mundësi të shënimit të teksit (sqarimi 01) dhe ngarkimin e dokumentacionit të kërkuar për plotësim (sqarimi 02).

Pas përfnudimit të plotësimit nga ana Juaj, **kiko në butonin ruaj** i cili gjendet në qendër të pjesës së poshtme të faqes (sqarimi 03)




Në rast se karta Juaj merr ngjyrë të gjelbërt, dhe në kartën e juaj figuron teksti **"i miratuar"** e njëjta nënkupton që kërkesa juaj është vendim meritor dhe të njëtin vendim e gjeni në e-mailin e Juaj në formë të skanuar, apo mund ta shkaroni direkt nga karta e juaj në e-leja.

Vendimi i shtypur dhe i vulosur mund të pranohet nga ana Juaj në cdo kohë pasi në kartën e juaj të figuron teksti "i miratuar", apo në e-mailin e Juaj keni pranuar vendimin nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës.

Në rast se karta Juaj merr ngjyrë të kuqe, dhe në kartën e juaj figuron teksti **"e refuzuar"** e njëjta nënkupton që kërkesa juaj është refuzar dhe të njëtin vendim e gjeni në e-mailin e Juaj në formë të skanuar, apo mund ta shkaroni direkt nga karta e juaj në e-leja.

Vendimi i shtypur dhe i vulosur mund të pranohet nga ana Juaj në cdo kohë pasi në kartën e juaj të figuron teksti "e refuzuar" apo në e-mailin e Juaj keni pranuar vendimin nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës.